

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

KONTRATË

Shërbime

"Ri-projektimi i Spitalit te Përgjithshëm te Ferizajt"

Numri i kontratës[1]: **206-24-26-2-2-1/C501**

Operatori ekonomik: **N.N.SH. "Vizion Project"**

NUI: **810540345**

[1] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

KONTRATË

Numri i kontratës[2]: **206-24-26-2-2-1/C501**

MINISTRIA E SHËNDETËSISË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.N.SH. " Vizion Project ", K.e Diellit Bl. IV H.IV, PRISHTINË, 600278370, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

"Ri-projektimi i Spitalit te Përgjithshëm te Ferizajt" me numër identifikues: **206-24-26-2-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

"Ri-projektimi i Spitalit te Përgjithshëm te Ferizajt"

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi per njesi pa TVSH	TVSH	Çmimi total me TVSH
1	Ri-projektimi i Spitalit te Përgjithshëm te Ferizajt, sipas Specifikave te Detyres Projektuese ne Aneksin 1 te DT.	cope	1	**56,600.00**	**10,188.00**	**66,788.00 €**

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **66,788.00** €; [gjashtëdhjetegjashtëmijë e shtatëqindetetëdhjetetetë] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

(f) Garancioni i ekzekutimit;

(g) ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

---

[2] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe[3] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		**Për Furnizuesin**	
Emri:	**Berat Marmullaku**	**Emri:**	Shkelqim Ofuk
Pozita:	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	**Pozita:**	DREJTOR.
Nënshkrimi:		**Nënshkrimi:**	
Data:	14.03.2024	**Data:**	14.03.2024
Vula:		**Vula:**	

[3] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tende0ruesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: **206-24-26-2-2-1/C501**

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te

kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërën nga këto arsye:

a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;

b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.
15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës qe duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

16.2 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar,** i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka

Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/ose

b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) Dëme të përgjithshme; ose

b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) vendim nga gjyqi; ose

b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **206-24-26-2-2-1/C501**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
~~Përshkrimi i nenit~~	~~Nr.~~ Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është: max. 10 ditë pas nënshkrimin nga te dyja palët.
	6.4	Data e Përfundimit është: max. 120 ditë kalendarike.
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është: Objekti i ri i SP te Ferizajt dhe MSh ne Prishtine.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është: Caktohet me vendim nga ZKA i MSH-se. Menaxhimi i kontratës do te behet ne konsultim me profesionistet shëndetësor qe do te angazhohen ne këtë projekt.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është **0.25% e Çmimit final të Kontratës** në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është **10%** të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% i vlerës totale te kontratës me vlefshmëri prej 150 dite.

Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për shërbimet e kryera vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.
Korrigjimi i defekteve	18.1	5.3.5 Projekti i Ujësjellësit dhe Kanalizimit Hidroizolimi, termoizolimimi dhe drenazhimi për bordum dhe suteren, janë të përfunduara pjesërishtë, por duhet të trajtohen përsëri, pasi që objekti ka probleme me ujëra nëntoksorë dhe mbitokësorë, rekomandohet që sidomos drenazhimi dhe hidroizolimi të trajtohet rishtas. Ndërsa hidoizolimi të trajtohet duke u bazuar në standardet europiane, EN 13956 05 1071 për themele, EN 13967 TS EN/EN 13491 standardi i homogjenitetit, EN 13501-5; 2017
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

SPITALI PËRGJITHSHËM FERIZAJ

DETYRË PROJEKTUESE

PROJEKTI: DOKUMENTACIONI TEKNIK PËR HARTIMIN E DETYRËS PROJEKTUESE PËR SPITALIN E PËRGJITHSHËM FERIZAJ

MSh, Prishtinë,

Përmbajtja

1.TË DHËNAT E PËRGJITHSHME 15
1.1 Informacione të përgjithshme rreth investitorit 15
1.2 Investimi në objekt 15
1.3 Lokacioni i objektit 16
1.4 Të dhënat e vend ndërtimit 16
1.5 Lidhja me projekte të tjera 16
1.6 Sqarimi i termave dhe kuptimeve 16
2.KËRKESAT THEMELORE 17
2.1 Hyrje 17
2.2 Qëllimet dhe kërkesat themelore të investitorit 17
2.3 Gjendja ekzistuese 17
2.4 Destinimi i objektit 19
2.5 Lokacioni i objektit 19
2.6 Objektivat 20
3.KUSHTET E PËRGJITHSHME 20
3.1 Specifikimi i projektit 22
3.2 Kushtet e përgjithshme për projektuesin 23
4.AKTIVITETET E PLANIFIKUARA 24
4.1 Dokumentacion për projektuesin 24
4.2 Lista e aktiviteteve 25
4.3 Afatet 27
5. DOKUMENTACIONI I PROJEKTIT 28
5.1 Dokumentacioni i projektit 28
5.2 Formati i dokumentacionit teknik 28
5.3 Përmbajtja e dokumentacionit teknik 30
5.3.1 Projekti Ideor 30
5.3.2 Projekti kryesor 30
5.3.3 Pjesa teknike e projektit 30
5.3.4.Projekti i fazës së statikës së objektit 32
5.3.5 Projekti i Ujësjellësit dhe Kanalizimit 33
5.3.6 Projekti i instalimeve elektrike 34
5.3.7 Projekti i instalimeve mekanike 35
5.3.8 Projektimi i hapësirave të jashtme të objektit me shpërndarje dhe lidhje me infrastrukturën komunale 37

5.3.9 Elaborati i sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga zjarri 38

5.4 Raporti i sigurisë në punë 39
5.4.1 Dokumentacioni i përgjithshëm 39

5.4.2 Pjesa teknike e elaboratit;..... 39

5.5 Projekti i gjendjes së ekzekutuar 39

5.6 Shëndeti dhe siguria në punë 40
5.6.1 Planifikimi i ndërtimit kryhet në disa hapa bazë:..... 40

6. TË DHËNAT BAZË PËR PROJEKTIN DHE KUSHTET TEKNIKE 40

6.1 Hapësirat organizative në bodrum 40
6.1.1 Arkiva e përgjithshme 41

6.1.2 Depo e barnave..... 41

6.1.3 Hapësira e sterilizimit dhe lavatorja..... 41

6.1.4 Hapësirat e shërbimeve teknike dhe mirëmbajtjes 43

6.1.5 Morgu..... 43

6.1.6 Hapësirat për vendosjen e gazrave medicinal, stacioni i kompresorëve, vakuumit, oksigjenit, ujit te ngrohet sanitar dhe kaldatorja..... 44

6.1.7 Depo për mbeturina komunale, infektive dhe të rrezikshme..... 44

6.2 Hapësirat organizative në suteren..... 44
6.2.1. Reparti radilogjisë dhe diagnostifikimit..... 45

6.2.2 Laboratorët 47

6.2.3 Transfuzioni i gjakut 49

6.2.4 Administrata e përgjithshme dhe dhoma e serverave..... 49

6.3 Hapësirat organizative në Përdhesë 50
6.3.1 Ordinancat specialistike ana e majtë e objektit 51

6.3.2 Emergjenca..... 52

6.3.3 Ordinancat specialistike ana e djathtë e objektit 54

6.4 Hapësirat organizative në Katin I 55
6.4.1 Reparti i gjinekologjisë dhe neonatologjisë 55

6.4.2 Blloku operativ për gjinekologji dhe neonatologji..... 56

6.4.3 Blloku operativ me katër salla te operacionit..... 57

6.4.4 Reparti i kirurgjisë..... 59

6.5 Hapësirat organizative në Katin II 60
6.5.1. Reparti i pediatrisë 60

6.5.2 Shërbimi gjysmë intensiv 61

6.5.3. Blloku operativ me gjashtë salla te operacionit 61

6.5.4 Reparti i ortopedisë dhe urologjisë 63

6.6 Hapësirat organizative në Katin III 64
6.6.1 Reparti i sëmundjeve të brendshme 64

6.6.2 Kateterizimi qendror 66

6.6.3 Reparti i hemodializës 66

6.7 Hapësirat organizative në Katin IV 67
6.7.1 Reparti i sëmundjeve të kraharorit dhe kardiologjisë 68

6.7.2 Kuzhina qendrore dhe restorantet 69

6.7.3 Amfiteatri 70

7.1 UDHËZUESI PËR PROJEKTIM TË OBJEKTEVE SPITALORE DHE STANDARDET 70
7.1.1 Mbështjellësi ndërtimor 71

7.1.2 Struktura mbështetëse e mbështjellësit të ndërtesës 72

7.1.3. Konstruksione mbrojtëse të mbështjellësit të ndërtesës 73

7.1.4. Dritaret 73

7.1.5 Elementet ndarëse të brendshme 74

7.1.6 Përpunimi final i elementeve të brendshëm ndarëse (muret, dyshemet, tavanet) 74

7.1.7 Dyert 76

7.1.8 Hapësira e nyjeve sanitare 76

7.1.9. Komunikimet 77

7.2 Hyrjet 77
7.2.1 Hyrja kryesore 77

7.2.3 Lobi kryesor 77

7.2.4 Korridoret 78

7.2.5 Shkallët 79

7.2.6 Rampat 80

7.2.7 Ashensorët 80

7.3 Rregullimi i jashtëm dhe trafikut 81

7.4 Shënim - komunikim vizual 81

7.5 Dhomat për pacientë 81

7.6 Instalimet në objekt 81
7.6.1 Instalimet elektrike 81

7.6.2 Ndriçimi emergjent 82
7.6.3 Sistemi qendror i kontrollit (BMS) 82
7.6.4 Sistemi i ujësjellsit dhe kanalizimit 82
7.6.5 Sistemi i ujit të ngrohët sanitar 82
7.6.6 Sistemi i ngrohjes klimatizimit dhe ventilimit 82
8.1 STANDARDET DHE DOKUMENTE TË TJERA STANDARDIZIMI 1
8.1.1 Fusha e arkitekturës dhe e ndërtimit 1
8.1.2 Fusha e inxhinierisë elektrike dhe teknologjisë së komunikimit dhe informacionit 2
8.1.3 Fusha e inxhinierisë mekanike 3
8.1.4 Fusha e gazeve mjekësore 80
8.1.5 Fusha e sigurisë nga zjarri 80

1.TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

1.1 Informacione të përgjithshme rreth investitorit

Investitor: **Ministria e Shendetësisë**

Adresa: **Rr. Zagrebit Nr. 60, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës**

Qyteti: **Prishtinë**

1.2 Investimi në objekt

Projekti investues: **Spitali Përgjithshëm i Ferizajit**

Adresa e objektit: **Rr. Driton Islami Ferizaj**

Tema: **Objekti i kësaj detyre projektuese është zhvillimi i një projekti për ndërtimin e Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj**

Qëllimi i detyrës së projektit është që perveç afrojë kërkesave themelore,ti ofrojë projektuesit edhe kërkesat specifike të investitorit për të projektuar një objekt që do të plotësojë të gjitha nevojat e investitorit dhe pacientëve.

Në këtë dokument janë trajtuar kërkesat që do të sigurojnë ndërtimin e një objekti që do t'i shërbejë nevojave për një kohë të gjatë.

Pas krijimit të projektit ideor, investitori do ta rishikojë atë dhe do t'ia jape komentet dhe sygjerimet dhe detajet shtesë projektuesit për përgatitjen e projektit kryesor për të plotësuar projektin në tërsi.

1.3 Lokacioni i objektit

Në lokacionin i cili gjendet në Ferizaj është ndërtuar objekti (vetëm faza e konstuksionit) me sipërfaqe prej 22,275.00m².

1.4 Të dhënat e vend ndërtimit

Në emër të investitorit projektuesi është i detyruar të marrë kushtet e urbanistikës dhe të gjitha bazat e nevojshme gjeodezike

1.5 Lidhja me projekte të tjera

Ky projekt nuk është i lidhur me projekte të tjera dhe përfaqëson një subjekt të veçantë.

1.6 Sqarimi i termave dhe kuptimeve

Termat e përdorur në këtë Detyrë Projektuese kanë kuptimet e mëposhtme:

- **Investitori:** Përfaqësohet nga Ministria e Shendetësisë
- **Dokumentacioni teknik (DT):** Ai përfshin një sërë projektesh dhe studimesh që është duke u përpunuar teknikisht ndërtimi i objektit të ri të Spitalit Përgjithshëm në Ferizaj
- **Detyra e projektit (DP):** përfshin detyrat e projektit për krijimin e projektit ideor dhe kryesor(zbatues), projekti i gjendjes së realizuar të ndërtimit të objektit të ri të Spitalit Përgjithshëm në Ferizaj
- **Projekti paraprak:** Këtu përfshihet projekti për ndërtimin e objektit të ri të Spitalit Përgjithshëm në Ferizaj nëpërmjet një procedure të hapur vendase për përgatitjen e dokumentacionit investiv
- **BO:** Bllok Operativ
- **Projekti i zbatimit:** Përfshin projektin e zbatimit të ndërtimit të Spitalit Përgjithshëm në Ferizaj, dhe duhet bërë në bazë të Projektit Ideor të miratuar dhe dokumentacionit tjetër shoqërues të projektit
- **Pëlqimi urbanistik:** Nënkupton pëlqimin urbanistik të marrë në bazë të Projektit Ideor të rishikuar
- **Projektuesi:** Nënkupton projektuesin ose organizatën e cila realizon projektit bazuar në procedurën e duhur të prokurimit si ofertues më i favorshëm
- **Objekti:** Spitali Përgjithshëm në Ferizaj
- **SP:** Spitali i Përgjithshëm
- **SO:**Sallë e operacionit
- **BO:** Bllok operativ
- **SQK:** Sistemi qendror i kontrollit (BMS)
- **Oborr ekonomik:** Përfshinë hapësirën e disponueshme në kuadër të parcellës së SP Ferizaj

2.KËRKESAT THEMELORE

2.1 Hyrje

Spitali Përgjithshëm i Ferizajit është një institucion ku punonjësit shëndetësorë janë të fokusuar tek pacienti.

Qëllimi është të kalosh përpjekjet e përbashkëta për t'i ofruar më të mirën në çdo aspekt këtij institucioni.

Prioritetet e këtij institucioni janë siguria shëndetësore shërbimin dhe orientimin ndaj pacientit dhe familjes së tij.

Qëllimi i këtij dokumenti është të paraqesë të gjitha aspektet kryesore që lidhen me përgatitjen e dokumentacionit teknik me qëllim ndërtimi i objektit brenda afatit të planifikuar në mënyrën e përcaktuar me lejen e ndërtimit, detyrën projektuese dhe respektimin e të gjitha rregulloreve, standardeve dhe masave ligjore përkatëse të vlefshme lidhur me cilësinë e ndërtimi dhe materialet dhe pajisjet e përdorura, me theks të veçantë në masat mbrojtëse dhe shëndetësore në punë dhe mbrojtjen e mjedisit sipas ligjeve aktuale në fuqi.

Kjo detyrë projektuese duhet të shërbejë si një udhëzim për vazhdimin e mëtejshëm të punës së dokumentacionit teknik investiv, bazuar në projektin ideor, kryesor për ndërtimin e Spitali Përgjithshëm në Ferizajit.

Projektuesi duhet, pas hartimit dhe rishikimit të projektit ideor dhe marrjes së miratimit urbanistik dhe pelqimit nga investitori, të vazhdojë përgatitja e projektit kryesor.

Rekomandimi i investitorit është që projektuesi të inspektojë dokumentacionin në dispozicion të objektit ekzistues.

2.2 Qëllimet dhe kërkesat themelore të investitorit

Objekti ekzistues i spitalit në Ferizaj, nuk ofron as kushte minimale sa i përket shërbimeve shëndetësore dhe nga aspekti i sigurisë, prandaj lindi nevoja për të ndërtuar një godinë të re, e cila do të garantonte sigurinë shëndetësore të gjithë përdoruesit e këtij institucioni.

Kjo situatë e vështirëson realizimin e proceseve të punës, andaj realizimi i këtij projekti mundëson punë më të sigurt dhe kushte normale për të gjithë punonjësit në Spitalin e Përgjithshëm në Ferizaj.

Qëllimi i investimit është sigurimi afatgjatë i kushteve më të mira për mbarëvajtjen e proceseve ditore të punës në SP, në mënyrë që kapaciteti dhe përmbajtja të plotësojnë kërkesat organizative dhe rregulloret e vlefshme për sistemimin e vendeve të punës, në përputhje me nevojat e shërbimeve individuale, kërkesat teknologjike dhe specifikat e secilit lloj të punës, brenda parcelës ndërtimore në dispozicion dhe kushteve urbanistiko-teknike.

2.3 Gjendja ekzistuese

Spitali i Përgjithshëm – Ferizaj, gjendët në qytetin e Ferizajit, me lokacion në pjesën veriore te qytetit, në rrugën Driton Islami.

Lokacioni i Spitalit eshte në një pozitë të favorshme sa i përket qasjeve nga i gjithë qyteti. Paraqitja e lokacionit të gjërë të Spitalit të përgjithshëm është në figurën 1, ndërsa kompleksi i Spitalit është paraqitur në figurën 2 dhe 3.



Figura 1. Paraqitja e vendndodhjes së Spitalit të përgjithshëm Ferizaj



Figura 2. Paraqitja e kompleksit të Spitalit të përgjithshëm Ferizaj.



Figura 3. Paraqitja e objektit të Spitalit të përgjithshëm Ferizaj.

Spitali i përgjithshëm i Ferizajit shtrihet në një sipërfaqe totale prej 22,275.00m², me një etazhitet B+S+P+4, me një formë të rregullt gjeometrike dhe sipas funsionit i ndarë ne 3 pjesë: krahu i majtë, qendra dhe krahu i djathtë i objektit.

Përveq qasjeve në objekt, qasjet në kompleksin e Spitalit si dhe rregullimi i jashtëm nuk janë të definuara dhe duhet të përcaktohet me projektin kryesor.

Objektit i është përfunduar faza e ndërtimit të vrazhdë, duke përfshirë, themelin, pllakat e meskatit, shtyllat, trarët, bërthamave të komunikimit vertikal, poashtu edhe muret e mbështjellësit të objektit nga blloka argjile.

Hidroizolimi, termoizolimimi dhe drenazhimi për bordum dhe suteren, janë të përfunduara pjesërishtë, por duhet të trajtohen përsëri, pasi që objekti ka probleme me ujëra nëntoksore dhe mbitokësore.

2.4 Destinimi i objektit

Objekti i ri i Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj duhet të sigurojë kushtet e nevojshme për një funksionim të qetë afatgjatë në zhvillimin e aktiviteteve ditore të punës dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

2.5 Lokacioni i objektit

Objekti i Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj ka dimensione të rregullta gjeometrike me sipërfaqe bruto deri në 22,275.00 m².

Projekti duhet të zgjidhë çështjen e rrugëve të trafikut të brendshëm, pra hyrje-daljet në objektin e SP.

Në projektin e rregullimit të jashtëm me lidhje me infrastrukturën komunale nevojitet pjesa grafike që tregon kufirin e parcelës.

Në paramasë dhe parallogari duhet ndarë pozicionet dhe sasitë që janë brenda parcelës nga pozicionet dhe sasitë jashtë parcelës.

Të gjitha pozitat brenda parcelës financohen nga buxheti i MSH, pozicionet jashtë parcelës janë kontribut komunal.

5.3.8.4 Paramasa dhe parallogaria e specifikuar në detaje dhe karakteristikat të pajisjeve dhe materialeve.

5.3.9 Elaborati i sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga zjarri

Si pjesë e dokumentacionit teknik, projektuesi është i detyruar (si pjesë e Projektit Kryesor) të bashkangjisë Elaboratet të cilat janë të listuara në pikën 2.1 të këtij dokumenti.

Raportet duhet të përmbajnë dokumentacionin e më poshtëm:

Dokumentacioni i përgjithshëm

Regjistrimi në regjistrin që tregon se personi juridik është i regjistruar për këtë veprimtari;

Autorizimi ligjor personat për elaborat (pika 2.1.);

Emrin, qëllimin, vendndodhjen e ndërtesës së projektuar;

Emrin dhe adresën e investitorit;

listën e projekteve dhe emrat e projektuesve që morën pjesë në zhvillimin e projektit kryesor.

5.3.9.1 Pjesa teknike e Elaboratit

Elaborati i mbrojtjes nga zjarri / pjesa teknike

Pjesa teknike e Elaboratit të Mbrojtjes nga Zjarri duhet të përmbajë të paktën:

Përshkrimi i objektit, qëllimit, vendndodhjen;

Vlerësimi i rrezikut nga zjarri duke marrë parasysh disponimin dhe qëllimin e objektit ndërtimor dhe veçoritë teknike teknologjike;

Përzgjedhja e zgjidhjeve teknike, teknologjike, elektrike, mekanike, ndërtimore dhe masave të tjera në funksion të mbrojtjes nga zjarri;

Përzgjedhja e masave, zgjidhjeve teknike dhe materialeve të ndërtimit në funksion të evakuimit dhe shpëtimit të njerëzve dhe të mirave materiale me përshkrim dhe udhëzime për procedurën e evakuimit;

Përzgjedhja e pajisjeve dhe mjeteve teknike për shuarjen e zjarreve, si dhe masave të tjera në funksion të shuarjes së zjarreve (rrugë, kalime, ujësjellës etj.);

Përshkrimin e organizimit të punës dhe udhëzimet e nevojshme lidhur me masat e zbatuara të mbrojtjes nga zjarri;

5.3.9.2 Paraqitja grafike e masave të zbatuara të mbrojtjes nga zjarri;

Lista e rregulloreve, standardeve dhe normave të aplikuara, d.m.th. rregullat e njohura dhe të dokumentuara të praktikës teknike jashtë vendit,të cilat nuk janë të rregulluara nga rregulloret e brendshme dhe që janë pranuar nga Republika e Kosoves.

5.4 Raporti i sigurisë në punë

Elaborati për mbrojtjen e mjedisit – Elaborati mbi ndikimin mjedisor

Raporti i ndikimit në mjedis përgatitet sipas nevojës, d.m.th nëse kërkohet nëpërmjet kushteve të DT/Vendndodhjes dhe përmban:

5.4.1 Dokumentacioni i përgjithshëm

a) Regjistrimi nga i cili shihet se personi juridik është i regjistruar për këtë veprimtari;

b) Autorizimi i personit juridik për përgatitjen e procesverbalit (pika 2.1.);

c) Emri, qëllimi, vendndodhja e ndërtesës së projektuar

d) Emri dhe adresa e investitorit

e) Lista e projekteve dhe emrat e projektuesve që morën pjesë në zhvillimin e projektit kryesor

5.4.2 Pjesa teknike e elaboratit;

a) Përshkrimi dhe qëllimi i objektit, Përshkrimi i pajisjes që planifikohet të instalohet, Përshkrimi i procesit teknologjik me paraqitje skematike të shkarkimeve në mjedis dhe gjenerimit të substancave, mbetjeve (ekzistuese dhe të planifikuara)

b) Lista e treguesve të ndikimit në mjedis me paraqitjen tabelare të treguesve të njohur

c) Ndikimi i pritshëm në mjedis (probabiliteti, kohëzgjatja dhe shpeshtësia)

d) Lista e llojeve dhe sasive të mbetjeve që do të krijohen nga ekzekutimi i punimeve të planifikuara

e) Masat e parashikuara për mbrojtjen dhe zbutjen e ndikimit në mjedis

5.5 Projekti i gjendjes së ekzekutuar

Projekti i gjendjes së ekzekutuar është një shtesë e projektin e zbatuar me të gjitha ndryshimet e bëra gjatë ndërtimit (nëse ka pasur ndryshime të tilla nga projekti kryesor) në pjesën të

projektit në të cilin janë bërë ndryshimet që janë në përputhje me lejen e ndërtimit të lëshuar dhe cilat janë miratuar nga projekti kryesor.

Nëse Inxhinieri Mbikëqyrës dhe Kontraktori kanë deklarojnë se ndërtesa është ndërtuar në të gjitha aspektet sipas leje ndërtimi dhe projektit kryesor dhe nuk ka ndryshime, projekti i gjendjes së ekzekutuar nuk bëhet.

Është detyrim i projektuesit të parashikojë gjatë përgatitjes së paramasës dhe parallogarisë të projektit kryesor ta parasheh edhe projektin e gjendjës së ekzekutuar.

5.6 Shëndeti dhe siguria në punë

Harmonizimi i projektimit me kërkesat e shëndetit dhe sigurisë në punë

5.6.1 Planifikimi i ndërtimit kryhet në disa hapa bazë:

Projektuesi dhe investitori duhet të bien dakord për teknologjitë e ndërtimit dhe metodat e ekzekutimit punon individualisht me masat e duhura të sigurisë, shëndetit në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, në mënyrë të tillë që të realizojë cilësinë e ndërtimit sipas projektit projektuar në kuadër të kushteve te investimit;

Projektuesi duhet të përcaktojë sekuencën teknologjike të punimeve dhe me ndihmën e koordinatorit përcaktoj mbivendosjet e lejuara në kryerjen e punëve të caktuara me zbatimin e masave shtesë dhe siguria në punë; duke bërë këtë, është e rëndësishme të merret parasysh kapaciteti i disa punimet, të cilat më vonë do të varen nga zgjedhja e kontraktorit;

Autoriteti Kontraktor dhe Projektuesi duhet të bien dakord për nivelin e rrezikut të pranueshëm për ekzekutimin e cilësisë së duhur të projektit, afati dhe me mjetet e parashikuara, dhe të përcaktohen ato pika kritike në procesin e ndërtimit.

Qëllimi është që investitorit ose shfrytëzuesit të objektit t'i ofrohen kushtet minimale të punës të përcaktuara me ligjin për mbrojtjen në punë, rregulloret që zbatohen në bazë të atij ligji dhe rregulloreve të veçanta për një aktivitet të caktuar.

6. TË DHËNAT BAZË PËR PROJEKTIN DHE KUSHTET TEKNIKE

6.1 Hapësirat organizative në bodrum

Hapësira e bodrum shtrihet në një sipërfaqe prej 4,192.00 m² dhe qasja nga ambienti i jashtëm në bodrum është vetëm përmes rampës së parkingut nëntokësorë.

Në bodrum janë paraparë të vendosen këto Reparte:

- Arkiva e përgjithshme,
- Depo e barnatoreve,
- Hapësira e sterilizimit dhe lavatorja,
- Hapësira e shërbimeve teknike dhe të mirëmbajtjes,
- Hapësira për vendosjen e gazrave medicinal, stacioni i kompresorëve,vakuumit dhe

oksigjenit, ujit të ngrohtë sanitar dhe kaldatorja

- Morgu
- Parkingu nëntokësorë.

Organizimi i hapësirës se bodrum është paraparë të funksionoj sipas këtij diagrami të paraqitur me poshtë,




Figura 1. Diagrami i ndarjeve të hapësirave në Bodrum.

6.1.1 Arkiva e përgjithshme

SHËNIM:

Arkiva është paraparë të vendoset ne anën e majtë të katit të Bodrumit dhe janë paraparë rreth 285.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë hapësirë.

6.1.2 Depo e barnave

SHËNIM:

Depo e barnave është paraparë të vendoset në anën e majtë të katit të Bodrumit dhe janë paraparë rreth 225.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtatën brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë hapësirë.

6.1.3 Hapësira e sterilizimit dhe lavatorja

SHËNIM:

Hapësira e sterilizimit dhe lavatorja janë paraparë të vendoset ne qendër të katit të Bodrumit dhe janë paraparë rreth 670.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë hapësirë.

Zona lokalet për pastrimin e rrobave të papastra:

- Pranimi i rrobave të papastra dhe klasifikimi
- Depo e rrobave të pastra
- Hapësirë për përgatitjen pjesëve te pastra dhe te dezinfektuara

Pjesa e pastër:

- Larja e rrobave
- Hekurosje, formatimi i rrobave
- Riparimi dhe etiketimi i rrobave
- Renditjen dhe paketim i rrobave
- Depo qendrore e rrobave,
- Hapësirë për karroca për shërbim të rrobave
- Depo për rroba qe hidhen

Hapësirat për staf për

- Zona e hyrjes erë mbrojtësi
- Hapësirë për udhëheqësin e lavatores
- Administrata
- Dhoma e mbikëqyrësit të lavatores
- Garderoba për stafit - f

me sanitare zona e tualetit

- (2 xWC, 2 x lavaman, 2 x dush)
- Garderoba për stafit - m

me sanitare zona e tualetit

- (WC, 2 x lavaman, dush)
- Hapësirë e stafit për pushim
- shërbimi i pastrimit

Hapësirat për sterilizim

Dhoma për pajisje teknike

- Stacioni i kompresorit
- Dhomë për dozimin dhe zbutës

6.1.4 Hapësirat e shërbimeve teknike dhe mirëmbajtjes

SHËNIM:

Hapësira e sterilizimit dhe lavatorja janë paraparë të vendoset në qendër të katit të Bodrumit dhe janë paraparë rreth 530.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë hapësirë.

Hapësirat e shërbimeve teknike dhe mirëmbajtjes

Hapësirat teknike dhe administrative

- Administrata për udhëheqësin
- Hapësirë për stafin teknik- planifikimi
- Hapësirë për stafin teknik- kontrolla
- Sistemi qendror i mbikëqyrjes
- Nyjet sanitare, mirëmbajtja,2x tualet - m, urinar, lavaman)

Punëtoritë

- Punëtoria elektrikes - universale
- Punëtoria për rregullime hidraulike, ujë i nxehtë, avullit dhe pajisjeve
- Punëtori për rregullime te pajisjeve klimatizimit dhe ventilimit

Depot

- Depo materialit teknik dhe pjesëve rezervë
- Depo për aparate zjarrit dhe pajisjeve emergjente

Servisimi i pajisjeve elektronike mjekësore

- Pranimi/lëshim dhe ruajtja e pajisjeve
- Servisimi i pajisje elektronike
- Inspektimet dhe kalibrimi i pajisjeve specifike
- Dhomë për rregullime mekanike
- Dhomë për dekontaminim
- Depo
- Arkiva – bibliotekë, informacione teknike
- Garazhe për dy automjete

6.1.5 Morgu

SHËNIM:

Hapësira e Morgut është paraparë të vendoset në anën e djathtë të katit të Bodrumit dhe janë paraparë rreth 210.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë hapësirë.

Hapësirat e morgut

Morgu

Nyjet sanitare Hapësira për përgatitjen e kufomave

Hapësira për pritjen e familjarëve

6.1.6 Hapësirat për vendosjen e gazrave medicinal, stacioni i kompresorëve, vakuumit, oksigjenit, ujit te ngrohet sanitar dhe kaldatorja

SHËNIM:

Hapësira për vendosjen e gazrave medicinal, stacioni i kompresorëve, vakuumit, oksigjenit, ujit te ngrohet sanitar dhe kaldatorja është paraparë të vendoset ne anën e djathtë të katit të Bodrumit dhe janë paraparë rreth 148.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë hapësirë.

Vërejtje: Projektuesi duhet të ketë parasysh se gjatë projektit ta parasheh edhe zhvendosjen e rezervuarit të oksigjenit të lëngët nga hapësira e spitalit të vjetër me kapacitet 5t i cili inkorporohet me kalkulimet e sistemit të gazrave mjekësore.

6.1.7 Depo për mbeturina komunale, infektive dhe të rrezikshme

SHËNIM:

Hapësira për vendosjen e gazrave medicinal është paraparë të vendoset ne anën e djathtë të katit të Bodrumit dhe janë paraparë rreth 96.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë hapësirë.

6.2 Hapësirat organizative në suteren

Hapësira e suterenit shtrihet në një sipërfaqe prej 3,008.00 m² dhe qasja nga ambienti i jashtëm në suteren është mjaftueshëm i rregullt për funksionim të Reparteve të cilat janë paraparë të vendosen në këtë etazhitet.

Në suteren janë paraparë të vendosen këto Reparte:

- Reparti i radiologjisë dhe diagnostifikimit,
- Laboratorët,

- Transfuzioni i gjakut,
- Administrata
- Serveri dhe IT.

Organizimi i hapësirës së suterenit është paraparë të funksionoj sipas këtij diagrami të paraqitur me poshtë:




Figura 1. Diagrami i ndarjeve të hapësirave në Suteren.

6.2.1. Reparti radilogjisë dhe diagnostifikimit

SHËNIM:

Reparti i radiologjisë eshte parapare të vendoset ne anën e majtë të Suterenit. Për këtë Repart janë paraparë rreth 900m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë Repart.

Hapësirat për pritje të pacienteve, regjistrim dhe administrata

- Regjistrimin administrata, triazhi
- Datoteka - në administratë
- Evidencat
- Dhomat e pritjes për pacientët – para hapësirave diagnostikuese
- Sanitare për pacientët

- Dy tualet, urinare, holl
- Tualet për persona me aftësi të kufizuara

Hapësirat Diagnostike:

- Universale - skelet, mushkëri
- Dy kabina për pacient
- Dhoma e ndërrimit

Diagnostifikimi gjinekologjik dhe urologjik

- Dy kabina për pacient
- Tualet – në hapësirën e diagnostifikimit
- Hapësirë për përgatitjen pacientin për dy persona

Diagnostifikimi gastrointestinal

- Dy kabina për paciente,
- Tualet
- Dhoma e ndërrimit
- Hapësirë për përgatitjen e pacientit

Mamografia (pozicioni në këmbë)

- Dy kabina për pacientë

Angiografi

- Hapësira e kontrollit (Angiografit)
- Hapësira teknike
- Hapësira për përgatitja e pacientit
- Hapësira për përgatitje për staf
- Depo e përshtatshme për kateter, kontraste dhe material steril
- Hapësirë për të vëzhguar pacientin pas intervenimit

Tomografia Kompjuterike - CT

- Kabina për ndërrimi,
- Hapësirë për të përgatitur pacientin
- Tualet - për pacientin
- Dhoma e ndërrimit
- Hapësira teknike

Rezonanca Magnetike - MRI

- Hapësirë për përgatitje pacientin

- Kabina për ndërrim
- Tualet për pacient
- Dhoma e ndërrimit
- Hapësira teknike

Hapësirat për diagnostifikim me ultrazë

- Diagnoza me ultrazë
- Hapësirë për biopsi me ultrazë
- Kabina për përgatitje të pacientit
- Hapësirë për të përgatitur pacientin
- Hapësira e pushimit për pacient

pas procedurave, me dy shtretër

Hapësira të përbashkëta teknike dhe ndihmëse për personelin

- Dhomë për përgatitjen e incizimeve
- Hapësirë për sistemin PACS
- Dy hapësira shërbimin e pastrimit
- Hapësira e mbeturinave dhe rrobave te pa pastra
- Hapësira për pushim, mini kuzhinë
- Dy tualete për staf

6.2.2 Laboratorët

SHËNIM:

Laboratorët janë paraparë të vendosen në qendër të Suterenit dhe janë paraparë rreth 815.00 m² hapësirë bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë Repart.

Hapësirat në Laboratorë

Zona për pranimin dhe grumbullimin e mostrave laboratorike

- Administrata, regjistrimi
- Dhome pritje për paciente
- Nyje sanitare për paciente
- Hapësirë për marrjen e urinës
- Tualet për persona me aftësi të kufizuara
- Hapësirë për marrjen e mostrave të gjakut

Zona pranimit dhe përgatitjes së

mostrave

- Hapësirë për pranimin dhe përgatitjen e mostrave
- Hapësirë për centrifug

Zona e laboratorëve

- Laboratori 1 – laboratori për analizat biokimike dhe imunologjike
- Laboratori 2 – Laboratori për analizat hematologjike
- Laboratori 3 – Laboratori i urinës dhe lëngjeve tjera trupore
- Kabineti udhëheqësit laboratorit

Zona teknike dhe hapësirat ndihmëse

- Lavaman enë qelqi, përgatitjen e ujit të laboratorit
- Depo laboratori për enë qelqi
- Dhomë për përgatitjen e reagentëve
- Hapësira e frigodhomës (+4 °C)
- Depo për material të ndezshme
- Hapësirë për aparate dhe pjesë rezervë.
- Dhomë për shërbimin e pastrimit,
- Hapësirë për mbledhjen e mbetjeve

Hapësirat për staf

- Administrata, sekretaria dhe arkiva
- Zyra e shefit të laboratorit
- Hapësira për librari, seminare dhe takime me nyje sanitare
- 2 Kabinete për biokimistë
- 2 Kabinete për hematolog
- Hapësirë për stafit me kuzhinë çaji

Shënim: Hapësirat e laboratorëve për shkak se janë të vendosura në suteren, projektuesi duhet të ketë kujdes rreth ndriçimi natyral dhe të bazohet në standarde europiane për laboratore .

Në çdo repart duhet të jetë së paku nga një tualet për personat me aftësi të kufizuara.

6.2.3 Transfuzioni i gjakut

SHËNIM:

Transfuzioni i gjakut është paraparë të vendoset në qendër të suterenit dhe janë paraparë rreth 290.00 m² hapësirës bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtatën brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë Repart.

Zona për pranimin dhe grumbullimin e mostrave laboratorike

- Administrimi, regjistrimi, pranimi i gjakut nga dhuruesit
- Dhoma e pritje dhe plotësimi i të dhënave
- Nyje sanitare për pacientë
- Hapësira për testimin e infeksioneve (laborator virusal)
- Hapësirë për grumbullimin e mbetjeve, që dalin nga grumbullimi dhe testimi i gjakut

Zona e ruajtjes dhe shpërndarjes së gjakut

- Hapësira për ftohjen
- Hapësira për frigodhomë

Hapësira për personel dhe hapësirat ndihmëse

- Hapësira për udhëheqësin e repartit
- Hapësira për kujdestari
- Nyjet sanitare(WC,lavaman,dush)
- Hapësira për pushim për stafin
- Garderoba
- Depo për material të pastër dhe steril
- Servisi i pastrimit dhe mbledhja e mbetjeve

6.2.4 Administrata e përgjithshme dhe dhoma e serverave

SHËNIM:

Administrata është paraparë të vendoset në anën e djathtë të suterenit dhe janë paraparë rreth 540.00 m² hapësirë bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit, ndërsa për hapësirën e serverit janë paraparë rreth 80 m² hapësirë bruto.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë Repart.

Hapësirat në Administratë dhe serverit

- Zyra për Drejtorin ekzekutiv
- Zyra për Drejtorin mjekësor
- Zyra për Drejtorin administratës
- Zyra për Drejtorin infermierisë
- Zyra për Shefin e personelit
- Zyra e dosjeve të personelit
- Zyra e prokurimit
- Zyra për Shefin e financave
- Zyra e dosjeve se financave
- Zyra për Shefin e shërbimeve teknike
- Zyra e zyrtareve, pranim,zotim,shpenzim, certifikim
- Zyra e koordinatorit te SISH-it,
- Zyra e operatoreve te SISH-it,
- Zyra e arkivës
- Zyra për shëndet dhe siguri në punë
- Zyra e zyrtarit te pasurisë
- Zyra e IT
- Zyra e zyrtarit ligjor
- Zyra e depos qendrore
- Zyra e barnatores qendrore
- Zyra e të hyrave vetanake
- Hapësirë e ndërrimit te uniformave për
- Higjienistët
- Hapësire e ndërrimit te uniformave për
- Punëtor Mirëmbajtës dhe teknik
- Salla e takimeve
- Nyjet sanitare,
- Dhomë me hapësire të lirë për vendosjen e serverëve

6.3 Hapësirat organizative në Përdhesë

Hapësira e përdheses shtrihet në një sipërfaqe prej 2,898.00 m² dhe qasja nga ambienti i jashtëm në përdhesë është mjaftueshme e rregullt për funksionim të Reparteve të cilat janë paraparë të

vendosen në këtë etazhitet.

Në përdhesë janë paraparë të vendosen këto hapësirat për këto destinime:

- Ordinancat specialistike ana e majtë e objektit
- Emergjenca
- Ordinancat specialistike ana e djathtë e objektit

Organizimi i hapësirës se përdhes eshte paraparë të funksionoj sipas këtij diagrami të paraqitur me poshtë:




Figura 1. Diagrami i ndarjeve të hapësirave në Përdhesë.

6.3.1 Ordinancat specialistike ana e majtë e objektit

SHËNIM:

Ordinancat specialistike janë paraparë të vendosen në anën e majtë të katit të përdheses dhe janë paraparë rreth 780.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese te objektit, të parapare për ketë destinim.

Hapësirat e ordinancave specialistike ana e majtë e objektit

- Ordinanca Urologjisë
- Hapësira për intervenime urologjike
- Ordinanca e ORL-se
- Hapësira për intervenime ORL-së

- Ordinanca Oftomatologjike
- Hapësira për intervenime oftomatologjike
- Ordinanca e sëmundjeve ngjitëse
- Ordinanca Kardiologjisë
- Hapësira për intervenime ECG
- Ordinanca e Pulmologjisë
- Ordinanca e Ortopedisë
- Hapësira për intervenime ortopedike
- Nyje sanitare për pacientë
- Tualet për paciente me aftësi të kufizuara (hendikep)
- Hapësira për mirëmbajtje dhe pastrim
- Nyje sanitare për personel
- Hapësirat për regjistrim, arkiva dhe faturim

6.3.2 Emergjenca

SHËNIM:

Emergjenca është paraparë të vendosët në qendër të katit të përdheses dhe janë paraparë rreth 1180.00 m² hapësirë bruto, duke u bazuar ne hapësirën ekzistuese te objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë destinim.

Hapësirat e Emergjencës
Qasja, rrugë për hyrje me makinë

- Rrugë e mbuluar për qasje me makinë
- Hapësira për qasje në këmbë zonë me autoambulanca, në pritje për t'u larguar pacientët
- Dhomë për shpëtimtarët me sanitare tualete
- Hyrja kryesore dhe pritorja
- Informacioni, kontrolli i hyrjes
- Dhoma e zhveshjes për pacient dhe shoqëruesit
- Nyje sanitare për pacientët dhe shoqëruesit:
  Tualet për personat me aftësi të kufizuara (Hendikep)
- Hapësira për ndërrim
- Hapësira për intervistim me të afërmit

Hapësirat për inspektimet parësore dhe

Triazhi dhe administrative pritje

(duke mundësuar privatësi për pacientin)

Arkiv e përshtatshme për dosje dhe administrim

Administrata

Vend ambulator për izolim

Dhome e izoluar e pritjes

Nyje sanitare

Hapësira e papastër në izolim

Dhomë për pastrim higjienik të pacientit

Hapësira për reanimim

Hapësira për rishikim të plagosurit (traumatike)

Hapësira për vendosje të gjipsit

Hapësira për rishikim intern mjekësor të pacientit

Depo për infermiere

Hapësira e mbikëqyrjes nga infermieret

Depo ambulantore dhe për material përcjellës

Njësia e vëzhgimit

Hapësira e pacientëve nën vëzhgim me 6 shtretër

Hapësira e kontrollit nga infermieret

Hapësira për pushim dhe kuzhinë çaji

Depo

Nyje sanitare me dush për pacientë

Dush për pacientë

Gardërobë për pacientët

Nyje sanitare për stafin

Dhomë për stafin

Blloku operativ emergjent

Filtër para hyrjes

Lavaman kirurgjike (për dy SO)

Salla e operacionit- septike

Salla e operacionit- aseptike

Substerilizimi

Depo e materialit steril

Depo e materialit të papastër dhe mbetjeve

Gardërobë filtër për stafin

Hapësirat për stafin

- Udhëheqës Reparti
- Dhomë për infermiere
- Dhomë pushimi për stafit
- Dhomë për evidence dhe shkrim
- Nyje sanitare për stafin
- Dhoma për stafin në detyre me
  me sanitare dhe tualet
- CT-tomografi kompjuterike,
- Laborator për nevojat e emergjencës,
- Hapësira për sigurimin (policin)

6.3.3 Ordinancat specialistike ana e djathtë e objektit

SHËNIM:

Ordinancat specialistike janë paraparë të vendosen në anën e djathtë të katit të përdheses dhe janë paraparë rreth 780.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen ne standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të parapare për ketë destinim.

Hapësirat e ordinancave specialistike ana e djathtë e objektit

- Ordinanca Gjinekologjisë
- Hapësira për intervenime gjinekologjike
- Ordinanca e Pediatrisë
- Hapësira për intervenime pediatrike
- Ordinanca Neurokirurgjisë
- Hapësira për intervenime neurokirugjike
- Ordinanca e Kirurgjisë Vaskulare
- Hapësira për intervenime k.vaskulare
- Ordinanca e Kirurgjisë Plastike
- Hapësira për intervenime k.plastike
- Ordinanca e Kirurgjisë Abdominale
- Ordinanca e Kirurgjisë Vaskulare
- Hapësira për intervenime k.abdominale
- Ordinanca e Nefrologjisë
- Hapësira për intervenime nefrologjike
- Nyje sanitare për pacientë
- Tualet për paciente me aftësi të kufizuara(hendikep)

- Hapësira për mirëmbajtje dhe pastrim
- Nyje sanitare për personel
- Hapësirat për regjistrim, arkiva dhe faturim

6.4 Hapësirat organizative në Katin I

Hapësira e katit I shtrihet ne një sipërfaqe prej 3,045.00 m² dhe qasja nga katet tjera është mjaftueshëm e rregullt për funksionim të mirëfilltë te Spitalit.

Në katin e parë janë paraparë të vendosen këto Reparte:

- Reparti i Gjinekologjisë dhe Neonatologjisë,
- Blloku operativ për Gjinekologji dhe Neonatologji me 2 salla të lindjes dhe 1 sallë operimi
- Blloku operativ me 4 salla të operimit,
- Reparti i kirurgjisë.

Organizimi i hapësirës së katin I është paraparë të funksionoj sipas këtij diagrami të paraqitur me poshtë,




Figura 1. Diagrami i ndarjeve të hapësirave në Katin I.

6.4.1 Reparti i gjinekologjisë dhe neonatologjisë

SHËNIM:

Reparti i Gjinekologjisë dhe Neonatologjisë janë paraparë të vendoset në anën e majtë të katit të parë dhe janë paraparë rreth 884.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese

të objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të parapare për këtë repart.

Reparti i Gjinekologjisë dhe Neonatologjisë

Hapësirat për pacientë (numri i shtretërve 18-24)

- Dhomat për pacientë me shtatzani të rrezikshme
- Dhoma për shtatzëna
- Dhoma për të sëmurit të posalindur
- Nyjet sanitare

Hapësira të përbashkëta funksionale dhe ndihmëse

- Hapësira për infermiere
- Hapësira për mjekun për inspektime
- Hapësira për mjekun për intervenime
- Mini kuzhina

Hapësira ndihmëse dhe staf

- Pranimi, administrata dhe arkiva
- Udhëheqësi i Repartit
- Hapësira për mjekë
- Hapësira për infermieret
- ~~Hapësira për mjekun kujdestar (mjeku në detyrë)~~
- Hapësira për takime
- Nyjet sanitare , garderoba për staf
- Hapësira për servisin e pastrimit dhe grumbullim të mbeturinave
- Kthina për instalime

Shënim: Hapësirat e cekura me lartë janë përcaktua në konsultim me GP, mirëpo pa marr parasysh këto ndarje, projektuesi ka të drejte të shtoj apo largojë hapësira në koordinim me investitorin duke u bazuar në standarde europiane për objekte spitalore.

Në çdo repart duhet të jetë së paku nga një tualet për personat me aftësi të kufizuara.

6.4.2 Blloku operativ për gjinekologji dhe neonatologji

SHËNIM:

Blloku operativ për gjinekologjisë dhe neonatologji është paraparë të vendoset në qendër të katit të parë dhe janë paraparë rreth 250.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për ketë repart.

Blloku operativ i Gjinekologjisë dhe Neonatologjisë

-Dy salla të lindjes,

-Hapësirat ndihmëse për sallat e lindjes

-dy salla të operacionit, me filtër lavaman kirurgjik

-Hapësira për të sapolindurit

-Nyjet sanitare dhe garderoba

-Hapësira për pastrim dhe mbetjeve

Shënim: Hapësirat e cekura me lartë janë përcaktua në konsultim me GP, mirëpo pa marr parasysh këto ndarje, projektuesi ka të drejte të shtoj apo largojë hapësira në koordinim me investitorin duke u bazuar në standarde europiane për objekte spitalore.

6.4.3 Blloku operativ me katër salla te operacionit

SHËNIM:

Blloku operativ është paraparë të vendoset në qendër të katit të parë dhe janë paraparë rreth 750.00 m^2 hapësirë bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë destinim.

Hyrja e pacientëve dhe stafit

- Kontrolli i hyrjes në Zona bllokut operativ (recepsioni)
- Dhoma e pritjes - parapërgatitja për pacientët
- Tualet
- Hapësira e materialit të pastër për bllok operativ
- Hapësirë për pacientët (i papastër/i pastër)
- Garderoba dhe filtri

Pjesa jo sterile:

- Gardërobë për veshje të jashtme – zhveshje
- Sanitare tualet - dush, lavamanë

Pjesa sterile

- Gardërobë rroba operative sterile dhe lavanderi
- Filtri dhe garderoba

Pjesa e papastër:

- Gardërobë për veshje të jashtme –

zhveshje

- Nyje sanitare (dush, 2x tualet, lavaman)

Pjesa e pastër:

- Gardërobë rroba operative sterile dhe lavanderi
- Hapësirë për dezinfektim
- Lavaman kirurgjik
- Hapësirë për material të papastër
- Hapësirë për shërbim të pastrimit

Zona bllokut operativ me hapësirat përcjellëse

- 4 salla të operacionit
- 4 hapësira për përgatitjen pacientit - anestezi
- 4 lavaman kirurgjik
- Depo e materialit të papastër
- Depo e materialit steril
- Depo për aparate, karroca, pajisje
- Përgatitja, magazinim i materialit anestetik

- Hapësira për aparatin mobil të rëntgenit
- 4 shtretër për pacientë nën vëzhgim pas operimit
- Hapësira e kontrollit të infermiereve
- Grumbullimi i mbeturinave

Zona hapësira për staf dhe administratë

- Hapësirë për administrim, menaxhim protokolleve
- Dhomë për menaxher-koordinatorin që punon në bllokun operativ
- Dhomë për udhëheqësin e instumentarëve e BO
- Hapësirë për takime, këshilli, seminar,
- Hapësirë për pushim stafit - 10 persona
- Dy dhomë pushimi kuzhinë çaji
- Higjienistët

- Kontrolli i anestezisë - monitorimi

6.4.4 Reparti i kirurgjisë.

SHËNIM:

Reparti i ortopedisë është paraparë të vendoset në anën e djathtë të katit të parë dhe janë paraparë rreth 880.00 m² hapësirë bruto, duke u bazuar ne hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë repart.

Reparti i kirurgjisë

Hapësirat për pacientë (numri i shtretërve 18-24)

- Dhomat për pacientë të pajisur me tualet lavaman
- Kuzhina doracake
- Nyjet sanitare

Hapësira të përbashkëta funksionale dhe ndihmëse

- Hapësira për infermiere dhe kontroll
- Hapësira për përgatitjen e terapisë, depo (barnat)
- Hapësira për përgatitjen intravenoze
- Hapësira për përgatitjen e mjekësisë orale
- Hapësira për mjekun për intervenime
- Banjë për pacientë me asistencë
- Mini kuzhina
- Nyjet sanitare
- Hapësira për servisin e pastrimit si dhe mbledhja e mbeturinave
- Depo

Hapësira ndihmëse dhe staf

- Pranimi, administrata dhe arkiva
- Udhëheqësi i Repartit
- Hapësira për mjekë
- Hapësira për infermieret
- Hapësira për mjekun kujdestar (mjeku në detyrë)
- Hapësira për takime
- Nyjet sanitare , garderoba për staf
- Hapësira për pushim-mini kuzhina
- Kthina për instalime

Shënim: Hapësirat e cekura me lartë janë përcaktua në konsultim me GP, mirëpo pa marr parasysh këto ndarje, projektuesi ka të drejte të shtoj apo largojë hapësira në koordinim me investitorin duke u bazuar në standarde europiane për objekte

spitalore.

Në çdo repart duhet të jetë së paku nga një tualet për personat me aftësi të kufizuara.

6.5 Hapësirat organizative në Katin II

Hapësira e Katit II shtrihet në një sipërfaqe prej 3,045.00 m² dhe qasja nga katet tjera është mjaftueshëm e rregullt për funksionim të mirëfilltë të spitalit.

Në katin e dytë janë paraparë të vendosen këto reparte:

- Reparti i Pediatrisë,
- Shërbimi gjysmë intensiv,
- Blloku operativ me 6 salla të operimit,
- Reparti i Ortopedisë dhe Urologjisë.

Organizimi i hapësirës së katin 2 është paraparë të funksionoj sipas këtij diagrami të paraqitur me poshtë:




Figura 1. Diagrami i ndarjeve të hapësirave në Katin II.

6.5.1. Reparti i pediatrisë

SHËNIM:

Reparti i Pediatrisë eshtë paraparë të vendoset në anën e majtë të katit të dytë dhe janë paraparë rreth 885.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen ne standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të parapare për këtë Repart.

Reparti i Pediatrisë

Hapësirat për pacientë (numri i shtretërve 18-24)

- Dhomat për fëmijë 2 deri 3 vjeç me shtrat edhe për nënat
- Dhoma për fëmijë parashkollor dhe shkollor

- Nyjet sanitare
- Kuzhina ditore
- Ordinanca

Hapësira ndihmëse dhe staf

- Pranimi, administrata dhe arkiva
- Udhëheqësi i Repartit
- Hapësira për mjekë
- Hapësira për infermieret
- Hapësira për mjekun kujdestar (mjeku në detyrë)
- Hapësira për takime
- Nyjet sanitare , garderoba për staf
- Hapësira për servisin e pastrimit dhe grumbullim të mbeturinave
- Hapësira për pushim të stafit dhe mini kuzhinë
- Kthina për instalime

Shënim: Hapësirat e cekura me lartë janë përcaktua në konsultim me GP, mirëpo pa marr parasysh këto ndarje, projektuesi ka të drejte të shtoj apo largojë hapësira në koordinim me investitorin duke u bazuar në standarde europiane për objekte spitalore.

~~Në çdo repart duhet të jetë së paku nga një tualet për personat me aftësi të kufizuara.~~

6.5.2 Shërbimi gjysmë intensiv

SHËNIM:

Shërbimi gjysmë intensiv është paraparë të vendoset në qendër të katit të dytë dhe janë paraparë rreth 285.00 m² hapësirë bruto, duke u bazuar ne hapësirën ekzistuese te objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë destinim.

Shërbimi gjysmë intensiv

- Këtë hapësirë mund të sistemohen fëmijët për njësinë intensive dhe izolimit

6.5.3. Blloku operativ me gjashtë salla te operacionit

SHËNIM:

Blloku operativ është paraparë të vendoset në qendër të katit të dytë dhe janë paraparë rreth 1020.00 m² hapësirë bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtatën brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë destinim.

Blloku operativ me gjashtë salla të operimit

Hyrja e pacientëve dhe stafit

- Kontrolli i hyrjes në Zona bllokut operativ (recepsioni)
- Dhomë e pritjes - parapërgatitja për pacientët
- Tualet
- Hapësira e materialit të pastër për bllok operativ
- Hapësirë për pacientët (i papastër/i pastër)
- Garderoba dhe filtri

Pjesa jo sterile:

- Gardërobë për veshje të jashtme -zhveshje
- Sanitare tualet - dush, lavamanë

Pjesa sterile

- Gardërobë rroba operative sterile dhe lavanderi
- Filtri dhe garderoba

Pjesa e papastër:

- Gardërobë për veshje të jashtme – zhveshje
- Nyje sanitare (dush, 2x tualet, lavaman)

Pjesa e pastër:

- Gardërobë rroba operative sterile dhe lavanderi
- Hapësirë për dezinfektim
- Lavaman kirurgjik
- Hapësirë për material të papastër
- Hapësirë për shërbim të pastrimit

Zona bllokut operativ me hapësirat përcjellëse

- 6 salla të operacionit
- 6 hapësira për përgatitjen pacientit - anestezi
- 6 lavaman kirurgjik
- Depo e materialit të papastër
- Depo e materialit steril
- Depo për aparate, karroca, pajisje, pjesë rezervë
- Përgatitja, magazinim i materialit anestetik
- Hapësira për aparatin mobil të rëntgenit
- 6 shtretër për pacientë nën vëzhgim pas operimit
- Hapësira e kontrollit të infermiereve
- Grumbullimi i mbeturinave

Zona hapësira për staf dhe administratë

- Hapësirë për administrim, menaxhim protokolleve
- Dhomë për menaxher-koordinatorin që punon në bllokun operativ
- Dhomë për udhëheqësin e instumentarëve e BO
- Hapësirë për takime, këshillime
- Hapësirë për pushim stafit - 10 persona
- 4 dhoma pushimi, kuzhinë çaji
- Higjienistët
- Kontrolli i anestezisë - monitorimi

6.5.4 Reparti i ortopedisë dhe urologjisë

SHËNIM:

Reparti i Ortopedisë dhe Urologjisë është paraparë të vendoset në anën e majtë të katit të dytë dhe janë paraparë rreth 885.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë repart.

Reparti i Ortopedisë dhe Urologjisë

Hapësirat për pacientë (numri i shtretërve 18-24)

- Dhomat për fëmijë (për ortopedi)
- Dhoma për të rritur (për urologji)
- Nyjet sanitare
- Kuzhina ditore
- Ordinanca për intervenime ortopedike
- Ordinanca për intervenime urologjike, cistoskopi, urodinamike

Hapësira ndihmëse dhe staf

- Pranimi, administrata dhe arkiva
- Udhëheqësi i Repartit të ortopedisë
- Udhëheqësi i Repartit të Urologjisë
- Hapësira për mjekë (ortoped)
- Hapësira për mjekë (urolog)
- Hapësira për infermieret (ortopedi)
- Hapësira për infermieret (urologji)
- Hapësira për mjekun kujdestar (mjeku në detyrë)
- Hapësira për takime
- Nyjet sanitare , garderoba për staf

- Hapësira për servisin e pastrimit dhe grumbullim të mbeturinave
- Hapësira për pushim të stafit dhe mini kuzhinë
- Kthina për instalime

Shënim: Hapësirat e cekura me lartë janë përcaktua në konsultim me GP, mirëpo pa marr parasysh këto ndarje, projektuesi ka të drejte të shtoj apo largojë hapësira në koordinim me investitorin duke u bazuar në standarde europiane për objekte spitalore.

Në këtë repart më se shumti do të ketë dhoma për ortopedi se sa për urologji, pasi që ortopedia ka nevoje për më shumë shtretër.

Në çdo repart duhet të jetë së paku nga një tualet për personat me aftësi të kufizuara.

6.6 Hapësirat organizative në Katin III

Hapësira e Katit III shtrihet në një sipërfaqe prej 3,045.00 m² dhe qasja nga katet tjera është mjaftueshëm e rregullt për funksionim të mirëfilltë te Spitalit.

Në katin e tretë janë paraparë të vendosen këto reparte:

- Reparti i sëmundjeve të brendshme,
- Kateterizimi qendror,
- Reparti i Hemodializës,

Organizimi i hapësirës se katin 3 është paraparë të funksionoj sipas këtij diagrami të paraqitur me poshtë,




Figura 1. Diagrami i ndarjeve të hapësirave në Katin III.

6.6.1 Reparti i sëmundjeve të brendshme

SHËNIM:

Reparti i sëmundjeve të brendshme është paraparë të vendoset në anën e majtë të katit të tretë dhe janë paraparë rreth 1,390.00 m² hapësire bruto,duke u bazuar ne hapësirën ekzistuese të objektit. Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë repart.

Reparti i Sëmundjeve të Brendshme

Hapësirat për pacientë (numri i shtretërve 18-24)

- Dhomat për pacientë të pajisur me tualet lavaman
- Kuzhina doracake
- Nyjet sanitare

Hapësira të përbashkëta funksionale dhe ndihmëse

- Hapësira për infermiere dhe kontroll
- Hapësira për përgatitjen e terapisë, depo (barnat)
- Hapësira për pajisjet e repartit
- Hapësira për kolonoskopi
- Hapësira për gastroskopi
- Hapësira për endokrinë
- Banjë për pacientë me asistencë
- Mini kuzhina
- Nyjet sanitare
- Hapësira për servisin e pastrimit si dhe mbledhja e mbeturinave
- Depo

Hapësira ndihmëse dhe staf

- Pranimi, administrata dhe arkiva
- Udhëheqësi i Repartit
- Hapësira për mjekë
- Hapësira për infermieret
- Hapësira për mjekun kujdestar (mjeku në detyrë)
- Hapësira për takime
- Nyjet sanitare për staf
- Hapësira për pushim-mini kuzhina
- Kthina për instalime

Shënim: Hapësirat e cekura me lartë janë përcaktua në konsultim me GP, mirëpo pa marr parasysh këto ndarje, projektuesi ka të drejtë të shtoj apo largojë hapësira në koordinim me investitorin duke u bazuar në standarde europiane për objekte spitalore.

Në çdo repart duhet të jetë së paku nga një tualet për personat me aftësi të kufizuara, hapësira për grumbullimin e mbeturinave si dhe kthinat për instalime.

6.6.2 Kateterizimi qendror

SHËNIM:

Kateterizimi qendror është paraparë të vendoset në qendër të katit të tretë dhe janë paraparë rreth 55.00 m² hapësire bruto, duke u bazuar ne hapësirën ekzistuese te objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen ne standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, te parapare për ketë destinim.

6.6.3 Reparti i hemodializës

SHËNIM:

Reparti i hemodializës është paraparë të vendoset në qendër të katit të tretë dhe janë paraparë rreth 1449.00 m² hapësirës bruto, duke u bazuar ne hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të paraparë për këtë Repart.

Reparti i Hemodializës

- Hapësirat për pacientë (numri i shtretërve 20-28) që nuk kanë sëmundje ngjitëse
- Hapësira për pacientë me sëmundje ngjitëse HIV, HCV, HBS 10 shtretër
- Hapësira për pacientë më aftësi të kufizuara (handikep, invalid) 2-5 shtretër
- Hapësirë për dializë akute dy shtretër

Hapësira të përbashkëta funksionale dhe ndihmëse

- Hapësira e pritjes për pacientë
- Hapësirë për inspektime dhe intervenime,kateter etj
- Hapësira për infermiere dhe kontroll
- Hapësirë për pushim pas ndërhyrjes, intervenimit
- Hapësirë për përgatitjen e lëngjeve intravenoze me filtër
- Depo për material shpenzues për dializë
- Hapësirë për mirëmbajtjen e aparateve të dializës , aparate magazinimi, pjesë këmbimi etj
- Përgatitja e ujit për dializë; osmozë
- Banjë për pacientë me asistencë
- Mini kuzhina
- Nyjet sanitare
- Nyje sanitare për persona me aftësi të kufizuar
- Laborator për nevojat e hemodializës
- Hapësira për servisin e pastrimit si dhe mbledhja e mbeturinave
- Depo

Hapësira ndihmëse dhe staf

- Pranimi, administrata dhe arkiva
- Udhëheqësi i Repartit

- Hapësira për mjekë
- Hapësira për infermieret
- Hapësira për mjekun kujdestar (mjeku në detyrë)
- Hapësira për takime
- Nyjet sanitare për staf, garderoba
- Hapësira për pushim-mini kuzhina
- Kthina për instalime

Shënim: Hapësirat e cekura me lartë janë përcaktua në konsultim me GP, mirëpo pa marr parasysh këto ndarje, projektuesi ka të drejte të shtoj apo largojë hapësira në koordinim me investitorin duke u bazuar në standarde europiane për objekte spitalore.

6.7 Hapësirat organizative në Katin IV

Hapësira e Katit IV shtrihet në një sipërfaqe prej 3,045.00 m² dhe qasja nga katet tjera është mjaftueshëm e rregullt për funksionim të mirëfilltë të spitalit.

Në katin e katërt janë paraparë të vendosen këto hapësira për destinime:

- Reparti i sëmundjeve të kraharorit dhe kardiologjisë,
- Kateterizimi qendror,
- Amfiteatri
- ~~Kuzhina qendrore~~
- Restoranti për nevojat e spitalit
- Restoranti për vizitor

Organizimi i hapësirës së katin 4 është paraparë të funksionoj sipas këtij diagrami të paraqitur me poshtë:




Figura 1. Diagrami i ndarjeve të hapësirave në Katin IV.

6.7.1 Reparti i sëmundjeve të kraharorit dhe kardiologjisë

SHËNIM:

Reparti i sëmundjeve të kraharorit dhe kardiologjisë eshtë paraparë të vendoset në anën e majtë të katit të katërt dhe janë paraparë rreth 1,420.00 m² hapësirë bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara më poshtë bazohen në standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të parapare për këtë repart.

Reparti i Sëmundjeve të Kraharorit dhe Kardiologjia

Hapësirat për pacientë (numri i shtretërve 18-24)

- Dhomat për pacientë të pajisur me tualet lavaman
- Kuzhina doracake
- Nyjet sanitare

Hapësira të përbashkëta funksionale dhe ndihmëse

- Hapësira për infermiere dhe kontroll
- Hapësira për përgatitjen e terapisë, depo (barnat)
- Hapësira për koronografi, me hapësirat ndihmëse
- Hapësira për ergometri
- Hapësira për spirometri
- Hapësira për EKG
- Hapësira për evakuim të lëngut
- Banjë për pacientë me asistencë
- Mini kuzhina
- Nyjet sanitare
- Hapësira për servisin e pastrimit si dhe mbledhja e mbeturinave
- Depo

Hapësira ndihmëse dhe staf

- Pranimi, administrata dhe arkiva
- Udhëheqësi i Repartit të sëmundjeve të kraharorit
- Udhëheqësi i Repartit të kardiologjisë
- Hapësira për mjekë rep. sëmundjeve të kraharorit
- Hapësira për mjekë rep. kardiologjisë
- Hapësira për infermiere rep. kardiologjisë
- Hapësira për infermiere rep. sëmundjeve të kraharorit
- Hapësira për mjekun kujdestar (mjeku në detyrë)
- Hapësira për takime
- Nyjet sanitare për staf me garderoba për të dy Reparteve
- Hapësira për pushim-mini kuzhina
- Kthina për instalime

6.7.2 Kuzhina qendrore dhe restorantet

SHËNIM:

Kuzhina qendrore dhe restorantet janë paraparë të vendosën në anën e djathte të katit të katërt dhe janë paraparë rreth 1,125.00 m² hapësirë bruto, duke u bazuar në hapësirën ekzistuese të objektit.

Hapësirat e shënuara me poshtë bazohen ne standardet për objekte spitalore dhe duhet të përshtaten brenda hapësirës ekzistuese të objektit, të parapare për këto hapësira.

Kuzhina Qendrore dhe hapësirat përcjellëse

Hapësira për shërbim dhe distribuim

